



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:191189
Datë: 26.02.2024
Numri i dokumentit: 05376247

KPPP.nr.1436/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit “DLD Group” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, me adresë në Pejton rruga “Perandori Justinian” Nr.25, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.H. avokat nga Fushë Kosova, kundër debitorit Komuna e Prishtinës, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.614/23 të datës 24.08.2023, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Irfan Kërçagu, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 07.02.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Prishtinës, ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr.614/23 i datës 24.08.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Irfan Kërçagu, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “DLD Group” Sh.P.K., ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.614/23 të datës 24.08.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm faturës Nr.2022/0032 të datës 01.11.2022, duke detyruar debitorin që në emër të borxhit që rrjedh nga fatura e lartcekur, t’ia paguaj kreditorit shumën prej 1,875.00 Euro, me kamatë prej 8% sipas LMD-së që nga data e paraqitjes së propozimit për

përmbarrim e deri në ditën e ekzekutimit të pagesës, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim, për shkak të cenimit qenësor të rregullave të procedurës përmbarrimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Ka theksuar se urdhri për përmbarrim i lëshuar nga Përmbarruesi Privat është i pabazuar dhe i paqëndrueshëm, për faktin se e njejta faturë me nr.2022/0032 e datës 01.11.2022 në vlerë prej 1,875.00 Euro është paguar nga ana e debitorit. Ka theksuar se së bashku me prapësim ka bashkangjitur raportin e listës së Kuponit të shpenzimeve. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të abrogohet urdhri për përmbarrim i Përmbarruesit Privat.

Kreditore nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po qe se në të është treguar kreditore dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shumat dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbarrimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se fatura me nr.2022/0032 e datës 01.11.2022, në bazë të së cilës është lejuar përmbarrimi, nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm sipas nenit 29.3 të LPP-së, për faktin se në rastin konkret nuk vërtetohet që fatura është dorëzuar dhe është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori dhe nuk mund të identifikohet

se vula që figuron në këtë faturë i përket debitorit, ndërsa evidentimi i nënshkrimit në këtë faturë nuk përbën bazë të mjaftueshme për lejimin e përmbarimit ndaj debitorit-Komuna e Prishtinës. Gjykata e vlerësoi pretendimin e debitorit, se fatura me nr.2022/0032 e datës 01.11.2022 në vlerë prej 1,875.00 Euro, në bazë të së cilës është lejuar përmbarimi, është paguar nga ana e debitorit, mirëpo e gjeti si të pabazuar, ngase debitori nuk ka ofruar ndonjë provë relevante nga e cila rezulton se është bërë ndonjë pagesë për faturën konkrete, rrjedhimisht debitori ka bashkangjitur një raport të listës së Kuponit të shpenzimeve sipas numrit të Kuponit, nga e cila gjykata nuk mund ta vërtetojë faktin se debitori ka përmbushur detyrimin që rrjedh nga fatura me nr.2022/0032 e datës 01.11.2022 në shumën prej 1,875.00 Euro.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1436/23 me datë 07.02.2024

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.